

**THIRRJE PËR APLIKIM NË PROGRAMIN E DOKTORATËS NË SHKENCA
EKONOMIKE DHE JURIDIKE PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025, PRANË
UNIVERSITETIT “BARLETI”**

Dekanati i Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë shpall hapjen e aplikimeve për programin e doktoratës në “Shkenca Ekonomike dhe Juridike” për vitin akademik 2024-2025 në:

“Shkenca Ekonomike”:

- Kontabilitet
- Taksim
- Menaxhim, Sipërmarrje dhe Novacion
- Marketing dhe Sjellje Konsumatore

“Shkenca Juridike”:

- Studime Kushtetuese
- E Drejtë Ndërkombëtare Publike
- E Drejtë Evropiane
- E Drejta Tregtare në Bashkimin Evropian
- E Drejtë Penale dhe Procedurë Penale
- Ligji Penal dhe Parimet e Zbatimit të tij
- Kriminologji & Penologji
- Krimi Ekonomiko-Financiar

Hapja e programit të doktoratës për vitin akademik 2024-2025 bazohet në:

- Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM nr. 418, datë 10.05.2017, “Për standardet, kriteret, procedurat e krijimit, riorganizimit, ndarjes, shkrires ose mbylljes së institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre”;
- VKM nr. 112, datë 23.02.2018, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore ‘Doktor’ dhe standardet për marrjen e titujve akademikë ‘Profesor i Asociuar’ dhe ‘Profesor’, i ndryshuar me VKM nr. 808, datë 11.12.2019;
- VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e një programi studimi të ofruar nga IAL”;
- Vkm NR. 824, datë 24.12.2021 “Për kodin e cilësisë”;
- VKM nr. 777, datë 26.12.2018, “Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradës shkencore “Doktor”, ndryshuar me VKM Nr. 99, datë 5.2.2020”;
- Udhëzim nr. 29 datë 18.12.2019 “Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërore të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë”;
- Udhëzim nr. 29, datë 18.12.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”;
- Udhëzim nr. 1 i Ministrit të Arsimit, datë 14.01.2020 “Për licencimin, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve dhe programeve të studimit”, ndryshuar me Udhëzimin nr. 7, datë 31.03.2021;
- Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, Nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhës së huaj”, i ndryshuar;
- Statutin e Universitetit “Barleti”;
- Rregulloren “Për programet e studimit të doktoratës në Universitetin “Barleti”;
- Urdhërin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 406, datë 01.08.2024 “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë, doktoratë në “shkenca ekonomike dhe juridike” në Universitetin “Barleti”.

KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI PËR TË APLIKUAR NË PROGRAMIN E DOKTORATËS PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025, PRANË UNIVERSITETIT “BARLETI”.

1. Të këtë përfunduar studimet e larta në Ekonomi ose Drejtësi;
2. Të zotërojnë një diplomë Bachelor, Master i Shkencave ose një kualifikim ekuivalent në të njëjtën disiplinë ose të ngjashme, nga një program i akredituar, me një notë mesatare secila jo më pak se 8.0 (tetë) ose ekuivalente;
3. Çertifikatë e gjuhës angleze të nivelit B2 (sipas Kuadrit Evropian të Kualifikimeve), vërtetuar nga një institucion ndërkombëtar, i njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
4. Të mos jetë i dënuar penalisht;
5. Të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij, apo të mos jetë gjetur në shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, së të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave të plagjaturës.

KRITERE SPECIFIKE

Nëqoftëse do të aplikohet në programin e studimit Shkenca Juridike, pranë Departamentit të Drejtësisë të Universitetit Barleti, duhet të mbahen parasysh edhe këto kritere specifike:

- Të këtë përfunduar ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave” në një nga nënfushat e drejtësisë, si: E drejtë penale, e drejtë tregtare, e drejtë civile, e drejtë publike, e drejtë kushtetuese, e drejtë e BE, etj..

DOKUMENTACIONI PER APLIKIM

Dorëzimi i dosjes së aplikimit me dokumentacionin e duhur, bëhet pranë pranë zyrës së koordinatorit përgjegjës për doktoraturat në katin e parë, Dr. Beskida Dorda.

Aplikimet pranohen çdo ditë pune në orarin 8:00-16:00

Dosja e aplikimit duhet të përmbajë dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesa e studentit kandidat për të ndjekur programin e studimit të doktoraturës në të cilin përfshihet edhe nënfusha e kërkimit ku ka interes kandidati;
2. Curricullum Vitae;
3. Fotokopje e noterizuar e diplomave të dy niveleve me suplementet përkatëse;
4. Dëshmi për njohjen e gjuhës angleze;
5. Fotokopje e kartës së identitetit;
6. Lista e artikujve shkencore (nëse ka);
7. Dy rekomandime nga persona me tituj akademik;
8. Deklarata/angazhimi e udhëheqësit shkencor;
9. Deklaratë vetjake e kandidatit për studime të vetëfinancuara;
10. Projekt-propozimi i kërkimit shkencor, i cili përfshin metodologjinë që do të aplikohet, identifikimin e nevojave për studimin, pritshmëritë e studimit, mundësinë e planit të punës për fonde etj;
11. Vërtetim i IAL-së se kandidati është angazhuar si personel akademik, (nëse ka);
12. Dëshmi për pagesën e tarifës së regjistrimit;
13. Vetëdeklarimi i kandidatit për respektimin e rregullave etike dhe standardeve shkencore;
14. Dëshmi e gjëndjes gjyqësore.

Kuotat e departamenteve janë si më poshtë

Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës- 7 kuota

Departamenti i Drejtësisë - 6 kuota